



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 23 Prot.

Tiranë, më 19/05/2020

VENDIM
Nr. 13 datë 19.05.2020

**PËR
PEZULLIMIN E PROCESIT TË APLIKIMEVE PËR ANËTARË SENATI
AKADEMIK, REKTOR, DREJTUES I NJËSIVE KRYESORE DHE DREJTUES I
NJËSIVE BAZË, NË ZGJEDHJET E AUTORITETEVE DHE ORGANEVE
DREJTUESE NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË**

Në bazë të Vendimit të Senatit Akademik të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë nr. 45, datë 19.05.2020 “Për pezullimin e procesit të aplikimeve për anëtarë Senati Akademik, Rektor, drejtues i njësive kryesore dhe drejtues i njësive bazë, në zgjedhjet e autoriteteve dhe organeve drejtuese në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, Rregullores së Zgjedhjeve miratuar nga Senati Akademik i UMT-së me Vendimin nr.13, datë 12.02.2020 “Për miratimin e Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, KIZ-i pasi u njoh me Vendimin e Senatit Akademik të sipërcituar,

VENDOSI:

1. Të pezullojë procesin e aplikimeve për anëtarë Senati Akademik, Rektor, Drejtues të Njësive Kryesore, Drejtues të Njësive Bazë në zgjedhjet e autoriteteve dhe organeve drejtuese në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, deri në marrjen e një vendimi të dytë për këtë çështje.
2. KZF e fakulteteve të UMT-së të vijojnë me konstituimin e tyre si dhe me procedurat e tjera paraprake të organizimit dhe funksionimit të tyre.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, afishohet në ambjentet e UMT-së dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të UMT-së.

**KRYETAR
SILVANA BALA**

